



**AUTO CLUB
ALBANIA**

Automobile Club Albania
Rr. "Ismail Qemali" No. 32/1 Tirane 1019
Shqiperi
T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,
E: info@aca.al /W: www.aca.al

Datë: 22/09/2021

Nr. 22 Prot.

Drejtuar: Z. Artur BUSHI
Kryetar i Bashkisë Krujë

Për dijëni: Z. Alfred KRISTULI
Drejtor i Përgjithshëm, PMNZSH

Subjekti: Kërkesë për mbështetje për organizmin e garës sportive ndërkombëtare me autovetura "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021"

I nderuar Z. BUSHI,
I nderuar Z. KRISTULI

Klubi i Automobilit të Shqipërisë (ACA), me autoritetin e Federatës Shqiptare të Sporteve të Automobilizimit (FASA), do të organizojë në datat 11-12 Shtator 2021, aktivitetin e garës sportive ndërkombëtare të shpejtësisë me autovetura, "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021". Ky është viti i 8-të që kjo garë ndërkombëtare zhvillohet në territorin e Bashkisë Krujë.

Për realizimin e garës "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021" kërkojmë mbështetjen e Bashkisë Krujë në funksion të përdorimit të infrastrukturës rrugore dhe vënien në dispozicion të shërbimit të zjarrfikëseve.

"Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021" është garë sportive me autovetura e regjistruar zyrtarisht në Kalendarin Kombëtar Sportiv të FASA e cila ka të drejtën e organizimit të saj.

Kjo garë është gjithashtu e regjistruar dhe është e vlefshme për kampionatin e Federatës Ndërkombëtare të Automobilizimit (FiA www.fia.com) për Zonën e Europës Qëndrore (CEZ-FiA <http://www.cez-motorsport.com/2021/cez-hill-climb/>). Në garë do të marrin pjesë mbi 30 garues nga Shqipëria, Italia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Sllovenia, Kroacia, etj.

Klubi ACA dhe Federata FASA, për 7 vjet, organizojnë garën sportive ndërkombëtare në territorin e Bashkisë Krujë në Rrugën e Malit, në segmentin rrugor Mali i Krujës - Sarisalltik.

Aktiviteti sportiv automobilistik do të zhvillohet në dy ditë:

- datë 11 Shtator 2021, ditën e shtunë, ora 08:30 deri në orën 14:00, do të zhvillohet sesioni i provave zyrtare;
- datë 12 Shtator 2021, ditën e dielë, nga ora 09:00 deri në orën 15:00 do të zhvillohet sesioni i garave.

MEMBER OF





**AUTO CLUB
ALBANIA**

Automobile Club Albania
Rr. "Ismail Qemali" No. 32/1 Tirane 1019
Shqiperi
T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,
E: info@aca.al / W: www.aca.al

Vlerësojmë se zhvillimi i këtij aktiviteti sportiv ndërkombëtar është i rëndësishëm dhe i vlefshëm dhe do të kontribuojë pozitivisht në aktivitetin turistik të qytetarëve dhe Bashkisë Krujë që Ju drejtoni.

Për sa më sipër, me anë të kësaj shkrese kërkojmë mbështetjen Tuaj dhe të institucionit që drejtoni në organizimin e këtij event, sipas të gjithë procedurave përkatëse. Gjithashtu, gjatë javës së zhvillimit të aktivitetit është me rëndësi njoftimi për qytetarët nëpërmjet mjeteve Tuaja të komunikimit dhe mediave sociale për mbylljen e rrugës në dy ditët dhe oraret e përcaktuara për garën.

Paraprakisht, po Ju konfirmojmë se i jemi drejtuar për mbështetje dhe kemi vënë në dijeni strukturat e Policisë së Qarkut Durrës, Komisarariatit të Policisë Krujë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si edhe Spitalin e Krujës.

Gjej rastin të shpreh vlerësimin e Klubit ACA dhe Federatës FASA për kontributin e dhënë nga Bashkia Krujë në zhvillimin e edicioneve të mëparshme të kësaj gare, dhe të shpreh bindjen që do të gjejmë mbështetjen Tuaj dhe të Bashkisë Krujë për mbarëvajtjen e aktivitetit edhe këtë vit.

Ndërkohë, kemi kënaqësinë që t'iu ftojme Ju ose përfaqësuesit e Bashkisë në pjesëmarrjen në ceremoninë e dorëzimit të trofeve.

Duke ju falënderuar paraprakisht për kohën Tuaj, mbetemi në dispozicionin për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratat më të mira,

Eridon Lameborshi

Eridon LAMEBORSHI
Sekretar i Përgjithshëm
Auto Club Albania

